

VENDIM
Nr.169, datë 29.3.2006

PËR TRANSFERIMIN KAPITAL TË MAKINERIVE E TË PAJISJEVE TË FABRIKËS SË
USHQIMEVE PËR FËMIJË “ BABY FOOD”, NË REZERVAT E SHTETIT, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Makineritë dhe pajisjet e fabrikës së ushqimeve për fëmijë “Baby Food”, Tiranë, investim në proces që nga viti 1992, të transferohen pa pagesë, nga sheshi i kësaj fabrike në magazinat e Rezervave të Shtetit, Tiranë.

2. Shpenzimet për ngarkimin, transportin dhe shkarkimin e kontenierëve nga “Qyteti i nxënësve” deri në magazinat e Rezervave të Shtetit, Tiranë, të përballohen nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Me kërkesë të Rezervave të Shtetit, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të vërë në dispozicion të këtij institucioni, dokumentacionin përkatës dhe specialistë të industrisë ushqimore, për identifikimin dhe vlerësimin e makinerive e të pajisjeve, për shitjen e tyre.

4. Sipërfaqja e truallit, mbi të cilin do të ndërtohej kjo fabrikë, bashkë me ngrehinat provizore etj. t’i kalojnë, pa pagesë, në pronësi Ministrisë së Arsimit dhe e Shkencës, për ndërtimin e një shkolle.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha